[Shqiptarja.com]

E martë 19 Dhjetor 2023 - Përditësimi i fundit 12:42

Kërko

LIVE | Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet më të lexuara ka 5 minutave të fundit

1 Zambotta në Tiranë, komenton me shaka shortin e Europianit: Grupin e kalon Shqipëria dhe Italia

2 VIDEO/ 'Tj ja një vrasësi', aktori amerikan Alec Baldwin lufton me protestuesit pro-palestinez

3 Diskutohen 3 rezultat për komisionet betimore në 'Lojërat' Fetiaj: Propozimi ynë ka model tjetër gjermani! S'mund të ngrihet komision për çdo thashethem

4 Mashtroninë shoferas të huaj për investim në bursa fikticre, arrestohen 4 punëgjegjësit e 'call center'-ave në Tiranë, sekuestrohen 9 mijë euro (EMRAT)

5 Vrasja me burgun e Peqinit/ Raport Tv dyardh dënimisë e drejtorit: Sokol Mjacaj i lha gardianit se do marrim kafe! Paul ekzekutoi Arben Lleshin, pistoleta në qafë policit

Kronikë

Dyshohet se do kryente vrasje, në kërkim 23-vjeçari në Kurbin! Në makinë iu gjet snajper me precizion të lartë! Gjatë arratisjes rrezikoi jetën e policëve

Orgest Mehi, 23 vjeç është shpallur në kërkim nga policia e Lezhës, pasi dyshohet se do të kryente një vrasje, mesnatën e (18 dhjetorit). Siç njofton policia, në bazë të informacioneve, në vendin e quajtur 'Kryqëzimi i Fushë Kuqes', Kurbin, ata i bënë me shenjë ndalimi një makine në të cilën dyshohet se po qarkullonte i riu që do të kryente vrasje.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
18 Dhjetor, 15:19 | **Përditësimi: 18 Dhjetor, 15:57**

Share

LEZHË- Orgest Mehi, 23 vjeç është shpallur në kërkim nga policia e Lezhës, pasi dyshohet se do të kryente një vrasje, mesnatën e (18 dhjetorit). Siç njofton policia, në bazë të informacioneve, në vendin e quajtur 'Kryqëzimi i Fushë Kuqes', Kurbin, ata i bënë me shenjë ndalimi një makine në të cilën dyshohet se po qarkullonte i riu që do të kryente vrasje.

23-vjeçari, i cili po drejtonte makinën, sapo ka parë shërbimet e policisë, ka rritur shpejtësinë, duke rrezikuar edhe jetën e punonjësve të policisë që ishin në patrullë. Pasi është larguar me shpejtësi në fshatin Gurëz, ka braktisur automjetin dhe duke përfituar nga errësira është larguar me shpejtësi.

Gjatë kontrollit në makinë, policia ka gjetur një armë zjarri snajper me precizion të lartë, me një krehër me fishekë në fole gati për qitje, si dhe një çantë me fishekë të tjerë për këtë armë.

LEXO EDHE:
'Thirrje për ushtar', kolonel Fadil Ciroku: 428 vende të lira

Në kuadër të hetimeve, u arrestua Mateo Dashi, 21-vjeç, banues në fshatin Gurëz, Kurbin, si dhe u shpall në kërkim Gjon Martinaj 30 vjeç, banues në Fushë Kuqe, Kurbin.

Sipas policisë të dy dyshohen si bashkëpunëtorë të Orgest Mehi, 23 vjeç, banues në fshatin Gurëz, Kurbin (i shpallur në kërkim), për veprat penale "Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit luftarak".

Ndërkohë policia po vijon kontrollin për kapjen e Orgest Mehit dhe Gjon Martinajt.

Vijon puna hetimore në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për identifikimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale dhe për dokumentimin e plotë ligjor të saj.

M.Q./KT/Shqiptarja.com

TAG: gjon martinaj | Kurbin | mateo dashi | orgest mehi | Lezhë | snajper

Komento

Komente

Arturi: 18/12/2023 21:15
Martinajt apo cka? Di kush gje?
Përgjigju

Bim: 19/12/2023 10:14
Se di

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Arrestimi i Berishës të enjten në Kuvend, a duhet deputetët të votojnë pro?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Shisnin kanabis pranë shkollave në Shëngjin, 2 të arrestuar, nën hetim dhe 2 të mitur
18 Dhjetor, 14:27

Marrëveshja për emigrantët me Italinë, 'The Times' zbulon projektin e bazës në Lezhë
17 Dhjetor, 17:14

Moti i keq/ Reshje të dendura dëbore në Korçë e Kukës, dhjetëra familje pa energji elektrike në disa bashkë! Në Lezhë, era rrëzon pemën dhe dekoret festive
16 Dhjetor, 08:16

'Rrugëtimi im', prezantohet në Lezhë libri i Pashk Përvathit! Preç Zogaj: Piktori i talentuar edhe në letërsi! Ndue Dedaj: Shkruan me vertetësi e gjuhë të pasur

Elvis Hila
14 Dhjetor, 15:25

Lezhë, pensionistët në radhë për shpërblimin e fundvitit: Pak është, por kanë bërë sevap me ne

Elvis Hila
13 Dhjetor, 17:40

Lezha kundër marrëveshjes me Italinë për emigrantët, 700 qytetarë firmosin peticion: Kuvendi të mos e miratojë, do sjellë pasoja të rënda

Elvis Hila
13 Dhjetor, 14:37

Akuzohet për tjetërsim pronash, ish-kryebashkiaku i Lezhës Fran Rrokaj merret sërisi i pandehur
12 Dhjetor, 19:18

VIDEO/ Efektivi i Lezhës denoncon: Dy persona më zunë pritë dhe më qëlluan, iu kundërpërgjigja! AMP nis hetimin: Dyshohet se inskenoi ngjarjen
12 Dhjetor, 09:03

VIDEO+FOTO/ 13 mjete përfshihen në aksident në Rrugën e Kombit, shkak mjegulla dhe ngrica në rrugë! Dy të lënduar

Elvis Hila
11 Dhjetor, 07:38

Nënkalimi i Ishull-Lezhës 10 vjet i 'mbuluar' nga uji! Kalimi, sfidë për shoferët: S'po gjejmë zgjidhje! Bashkia: Është në varësi të ARRSH-së
10 Dhjetor, 21:59

Memoriali i Skënderbeut vizitohet nga mbi 17 mijë turistë për 10 muaj! Përgjegjësi: Shifër rekord, më shumë vizitorë nga Holanda

Elvis Hila
9 Dhjetor, 15:44

Nisma e 15 shefave të njohur të kuzhinës në Lezhë, mbrëmje bamirësie! Mblidhen 15 mijë euro për vajzat e dhunuara

Elvis Hila
8 Dhjetor, 19:40

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje